



KOMUNIKATË

19.01.2010

Në mbledhjen e 8-të të radhës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka diskutuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me punën e KQZ-së në përgjithsi. Kryetarja znj. Nesrin Lushta, në fillim ka kërkuar miratimin e rendit të ditës. Pas miratimit të rendit të ditës, anëtarët e KQZ-së kanë aprovuar raportet nga mbledhjet e kaluara me vërejtjet që raportet të jenë më të kompletuara. Janë miratuar raportet nr. 74/09, nr. 76/09, nr. 77/09, nr.78/09, nr. 79/09, nr. 80/09, nr. 81/09 dhe nr. 84/09.

Kryshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, e informoi KQZ-në për takimet me KFOR-in, Policinë e EULEX-it, OSBE-në lidhur me aktivitetet dhe përgatitjet e procesit zgjedhorë në komunën e Prizrenit dhe të Lipjanit, ku edhe do të zhvillohen rivotimet për Kryetar të Komunave. Prej datës 16.01.2010, janë zhvilluar trajnimet dyditore të KVV-e.

Kryesuesit dhe anëtarët e KVV-ve që kanë qenë të angazhuar në procesin zgjedhorë të 15 nëntorit dhe 13 dhjetorit dhe ku janë anuluar rezultatet e votimit, nuk do të angazhohen më në ato vendvotime në procesin e rivotimit në komunat e Prizrenit dhe të Lipjanit.

Është dërguar një ekip në Slloveni për monitorimin e procesit të prodhimit të fletëvotimeve. Më datën 20.01.2010 fillon shtyja e prodhimit të LPV-e dhe format e paketimit, zarfet, etiketat, FPR-të, vulat e reja dhe disnjektivat për KVV-të dhe vëzhguesit.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, e informoi KQZ-në se është duke u punuar lidhur me akreditimin e vëzhguesëve, si dhe raportet financiare të partive politike.

KQZ ka miratuar kërkesat e Kryesive të Kuvendeve Komunale në komunën e Deqanit, Skënderajt, Burimit dhe të Kllokotit.